



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Agjencia e Kosovës për Akreditim**  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 544/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

**V E N D I M**

- I. Riakreditohen programet e studimit i Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018:
  - Matematikë, BSc, 180 ECTS, maksimumi 120 studentë për vit akademik;
  - Matematikë, MSc, 120 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik.
- II. Nuk riakreditohet programi i studimit i Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”:
  - Biologji e Përgjithshme, MSc, 120 ECTS
- III. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- IV. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programeve të studimit: Matematikë, BSc, 180 ECTS, Matematikë, MSc, 120 ECTS, dhe Biologji e Përgjithshme, MSc, 120 ECTS me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Matematikë	BSc	180	Ramadan Zejnullahu, Muhib Lohaj, dhe Kajtaç Bllaca
2	Matematikë	MSc	120	Bujar Fejzullahu, Naim Braha, dhe Rexhep Gjergji
3	Biologji e Përgjithshme	MSc	120	Kemajl Bislimi, Linda Grapci Kotori, dhe Bekim Gashi

AKA ka organizuar vizitën në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore më 23.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekura me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Mladen Krajacic dhe Peeter Normak.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me programet e studimit Matematikë në nivelin BSc dhe MSc, ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit ka vërejtur se nga gjithsejtë 25 rekomandime të dhëna nga ekipi paraprak i ekspertëve në vitin 2014, Fakulteti i Shkencave Matematike- Natyrore për vitin 2017 ka deklaruar se për shumicën e atyre rekomandimeve aktivitetet janë shtyrë apo aktivitetet janë në vazhdimësi. Edhe në ato raste kur Fakulteti ka deklaruar se rekomandimet janë në proces e sipër, ekipi i ekspertëve ka gjetur se ato aktivitete nuk janë përmbushur. Rrjedhimisht, ekipi i ekspertëve ka rekomanduar që programet në Matematikë në nivelin BSc dhe MSc të riakreditohen vetëm për një vit në mënyrë që Fakulteti të merr në konsiderim implementimin e rekomandimeve të dhëna në vitin 2014 si dhe rekomandimet për vitin 2017, sikurse rekomandimet për sistemin e sigurimit të cilësisë, gabimet e gjetura në raportin e vet vlerësimit etj.

Në lidhje me programin e studimit në Biologji, MSc, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Raporti i Vet Vlerësimit është hartuar dobët dhe teksti në raport është jo konsistent. Sipas ekspertëve, është e pritshme që nga profesorët universitarë të shkruhen saktë të paktën emrat e fakultetit të tyre apo fakultetit prej nga ata e kanë marrë thirrjen akademike.

Në anën tjetër, raporti nuk ka informata të pamjaftueshme për punën shkencore të Departamentit të Biologjisë. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë nuk ka qenë në gjendje të kuptojë se cilat janë publikimet e stafit akademik si dhe pozitat e tyre, përkatësisht titujt akademik që ata kanë.

Sipas ekspertëve ndërkombëtarë, shumica e përshkrimeve të lëndëve në raportin e vet vlerësimit nuk përkojnë me nivelin Master. Sipas tyre, përshkrimet e lëndëve janë më tepër të nivelit Bachelor dhe sipas ekspertëve studentët nuk kanë qenë në gjendje që të njohin përmbajtje më të avancuar, mirëpo sipas tyre më së shumti përmbajtja e lëndëve është përsëritje se çfarë është mësuar më herët në nivelin Bachelor.

Për sa i përket punës praktike, ekipi i ekspertëve ka mësuar nga studentët se ata bëjnë shumë pak apo nuk bëjnë fare praktikë. Mungesa e punës praktike për studentë do të thotë se kompetencat e pritura, kualifikimet dhe aftësitë të cilat pretendohen të arrihen nga studentët, sipas Raportit e Vet Vlerësimit, nuk janë arritur.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit Shkencave Matematike Natyrore;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë